

**LIGJ**  
**Nr. 153/2014**

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE DHE GJOBAVE PËR KONTRIBUTET E  
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PAPAGUARA NGA  
PERSONAT E VETËPUNËSUAR NË BUJQËSI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen kamatëvonesat dhe gjobat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të paguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ata mund të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore për periudha të kaluara dhe për vitin 2014 pa kamatëvonesa.

**Neni 2**

Kamatëvonesat dhe gjobat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 3**

E drejta e personave të vetëpunësuar në bujqësi që të përfitojnë nga falja e kamatëvonesave dhe gjobave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2014.

**Neni 4**

Kamatëvonesat dhe gjobat për kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

**Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 18.11.2014